



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2018

**V E N D I M**

**Nr. 18 , Datë 11 / 1 /2018**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 81, datë 03.08.2017, e bërë nga D.A, kundër OSHEE Berat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”.

Institucioni i Komisionerit gjatë takimeve të zhvilluara në Bashkinë Berat, në kuadër të aktivitetit “Ditë të hapura”, ka administruar disa ankesa lidhur me sjelljen dhe trajtimin e personave të komunitetit Rom dhe Egjiptian nga ana e subjekteve publike dhe private në Bashkinë Berat. Një nga këto ankesa është në emër të shtetasit D.A.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se: *“Në lagjen ku banon ka problem me voltazhin e energjisë elektrike, pasi energjia ka fuqi vetëm për ndriçim dhe nuk mund të përdorin pajisje të tjera elektrike dhe ky problem është vetëm për lagjen, Stan. D.A informon se ka dallim mes furnizimit (voltazhit) të lagjeve të tjera dhe lagjes Stan për shkak të racës”*. Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të ndalohet diskriminimi për komunitetin rom banorë të lagjes Stan.

Diskriminimi për shkak të racës është një nga shkaqet për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë*

*prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 784/1 prot, datë 23.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e OSHEE Berat, lidhur me ankesën e bërë nga D.A, për përmirësimin e situatës së furnizimit me energji elektrike të banesës së tij.

Me shkresën nr. 2000/1 Prot, datë 28.08.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, OSHEE Berat, informon se: *“Pas verifikimit në vend, rezulton se banesa e D.A furnizohet me energji elektrike nga kabina B-Moravë 2 (Stani), Fideri nr.26 (6kv), N/Stacioni Kombinat. Kjo kabinë furnizon me energji elektrike 103 abonentë të OSHEE.sh dhe transformatori është me fuqi 180 kVA. Nga matja e kryer në shtëpinë e D.A rezultoi se niveli i tensionit është 191 V dhe në një pikë tjetër niveli i tensionit ishte 196 V, ndërsa në kabinën elektrike tensionet fazore dhe lineare ishin: Fazë-fazë 389V dhe Fazë-Neutër 223V. Shkak për rënien e tensionit në shtëpinë e D.A dhe në pikat fundore të rrjetit të tensionit të ulët që furnizon këtë lagje është amortizimi i këtij rrjeti dhe shpërndarja e ngarkesës në mënyrë josimetrike sepse linja TU në shumicën e saj është 1 Fazore. Drejtoria Rajonale Berat e OSHEE sh.a ka hartuar Projekt-Preventivin e zbatimit për ndërtimin e një kabine të re në mënyrë që kabina ekzistuese ku furnizohet me energji elektrike lagjja Stan në Moravë të këtë më pak abonent e për rrjedhojë më pak ngarkesë, që do të thotë përmirësim të cilësisë së furnizimit me energji elektrike. Sektori teknik i Njësisë Berat në planin e remonteve të mesme të muajit Shtator 2017 do të fusë dhe remontin e linjës së tensionit të ulët të kabinës Moravë 2 (Stani), duke bërë zëvendësimin e përcjellësve të amortizuar, zëvendësimin e izolatorëve të dëmtuar, pastrimin e trasesë së linjës së tensionit të ulët nga pemët dhe simetrizimin e ngarkesave. Pas këtij remonti niveli i tensionit në shtëpinë e D.A dhe në gjithë lagjen Stan do jetë brenda paramentrave të lejuar dhe pajisjet elektrike do funksionojnë normalisht”.*

- Me shkresën Nr. 784/3 prot, datë 04.09.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar informacion shtesë nga ana e OSHEE Berat, lidhur me investimet e kryera në rajonin e Beratit.

Me shkresën nr. 2072/1 Prot, datë 12.09.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, OSHEE Berat, informon se: *“Në lagjen Stan të fshatit Moravë, OSHEE sh.a nuk ka kryer asnjë investim nga viti 2013 deri në vitin 2017. Por në këtë kabinë nga OSHEE janë kryer remonte si të mesme dhe profilaksi. Në fshatrat në kufi me fshatin Moravë, OSHEE nuk ka kryer investime nga viti 2013 deri në vitin 2017. Dhe në këto fshatra nga ana jonë*

janë kryer remonte të mesme ku janë zëvendësuar shtyllat e dëmtuara, zëvendësuar panelet e tensionit të ulët, zëvendësuar përcjellësit e amortizuar si dhe zëvendësuar izolatorët e dëmtuar, dhe remonte profilaktike që konsistojnë në pastrimin e kabinave, kryerjen e matjeve të ndryshme dhe pastrimin e traseve të linjave si të Tensionit të Mesëm dhe të Tensionit të Ulët. Për sa i përket investimeve të kryera nga OSHEE Berat në drejtim të përmirësimit të cilësisë së furnizimit të abonentëve ju informojmë se janë kryer 33 investime në Njësinë Lushnjë, 15 investime në Njësinë Berat, 31 investime në Agjencinë Kuçovë dhe 1 investim në Agjencinë Skrapar. Në kabinën Morava 2 e cila furnizon me energji elektrike dhe lagjen Stan nuk është planifikuar më parë të bëhen investime sepse linjat elektrike të kësaj kabine mund të kthehen brenda kushteve të sigurimit teknik dhe shfrytëzimit teknik nëpërmjet remontit. Në të ardhmen OSHEE Berat ka në plan për vitin që vjen të hartoj Projekt-Preventivat e zbatimit për rikonstruksionin e rrjetit të tensionit të ulët në gjithë Fiderin nr.26, duke e kthyer këtë rrjet nga rrjet me përcjellës ajror në rrjet kabllor ABC me vetëmbajtje. Gjithashtu theksoj se me remontin e fundit që kemi kryer te kabina Morava 2 është përmirësuar niveli i tensionit si te D.A dhe në të gjithë lagjen Stan të fshatit Moravë”.

- Mbështetur në Urdhrin nr.131, datë 06.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit pranë lagjes Stan, Moravë” Berat, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e I.A, inspektorët e KMD-s u paraqitën pranë banesës së D.A, më datë 12.10.2017, për të kryer verifikimet përkatëse.

Gjatë inspektimit pranë lagjes Stan, inspektorët morën takim me D.A i cili deklaroi se: “Gjatë muajit shtator janë paraqitur punonjësit e OSHEE-s të cilët kanë kryer punime riparimi dhe situata e furnizimit dhe tensionit të energjisë elektrike është përmirësuar. Për këtë, falënderoj Komisionerin për interesimin dhe ndërhyrjen për zgjidhjen e situatës”.

**Për sa më sipër, gjatë procesit të hetimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi dhe palës kundër së cilës drejtohej ankimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi:**

Sipas informacionit të administruar, lagjja Stan e fshatit Moravë, ka pasur probleme të tensionit të ulët në shtëpi, gjë shkaktonte probleme të përdorimit të pajisjeve elektro-shtëpiake të banorëve. Gjatë procedurave hetimore dhe nga informacioni i administruar<sup>1</sup>, Komisioneri, mori dijeni se situata problematike e krijuar, lidhur me furnizimin dhe tensionin e energjisë elektrike në banesa, është zgjidhur dhe nuk ekziston më.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se me punimet e kryera nga OSHEE Berat, problematika e D.A, është zgjidhur dhe vlerëson se u arrit qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të furnizimit të banesës së D.A me tension brenda parametrave të lejuar.

<sup>1</sup> Shkresat nr. 2000/1, datë 28.08.2017, nr.2072, datë 12.09.2017 të OSHEE Berat dhe ne referim të Procesverbalit të inspektimit datë 12.10.2017.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 81, datë 03.08.2017, të D.A, pasi u arrit dhe qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**